REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA DEVOLL**
**DREJTORIA E SHËRBIMEVE SOCIALE**
**SEKTORI I KUJDESIT SOCIAL DHE PAK**

**Nr.[illegible] Prot** **Devoll, më 26.1.2025**

# NJOFTIM

## MBI

## "MIRATIMIN E PËRFITUESVE NGA PROGRAMI SUBVENCIONI I INTERESAVE TË KREDISË PËR STREHIM"

Në zbatim të Ligjit Nr. 22/2018, "Për Strehimin Social", i ndryshuar, VKM Nr. 384, datë 12.06.2019, "Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfituar strehim sipas çdo programi social të strehimit dhe të afateve e procedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore", si dhe të VKM Nr. 453, datë 03.07.2019, "Për masën e subvencionit të interesave të kredisë dhe procedurën e dhënies së tij për familjet që përfitojnë banesë me kosto të ulët, me kredi të lehtësuar nga shteti", bazuar në shkresën Nr. 15406, datë 06.12.2024 të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë "Mbi zgjerimin e programit të subvencionit të interesave të kredisë për strehim",

Njoftohen qytetarët se për vitin 2025 janë përzgjedhur aplikantët e mëposhtëm për përfitim nga programi **"Kredi e Lehtësuar nga Shteti"**.

**Vijimi i procedurave**

Pas miratimit të listës nga Këshilli Bashkiak Bashkia Devoll dhe në përputhje me udhëzimet e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, bëhet me dije se:

Shkresa në lidhje me aplikantët të cilët kanë dalë fitues nga komisioni i strehimit dhe Këshilli Bashkiak u është dërguar tre bankave të nivelit të dytë bashkëpunuese:

- Banka Kombëtare Tregtare (BKT)
- Intesa Sanpaolo Bank Albania
- Raiffeisen Bank Albania

Bankat do të kryejnë verifikimet përkatëse sipas kritereve të programit të subvencionimit të interesave të kredisë.

Aplikantët e përfshirë në listë duhet të ndjekin komunikimin me bankat përkatëse për vijimin e procedurave të mëtejshme. Familjet e miratuara me Vendim të Këshillit të Njësisë së Vetëqeverisjes Vendore, për të përfituar nga programi i kreditimit, duhet të kujdesen për gjetjen e blerjen e një banese në treg të lirë. Afati maksimal për kryerjen e procedurave të përfitimit të kredisë është 18 (tetëmbëdhjetë) muaj nga data e protokollimit të listës emërore pranë institucionit, që monitoron subvencionimin e interesave të kredisë.

Individi/familja, që ende nuk ka gjetur banesën, njofton nëpërmjet postës elektronike, çdo 6 (gjashtë) muaj, institucionin financiar dhe nëpërmjet portalit qeveritar "e-Albania", institucionin që monitoron subvencionim e kredisë për shfaqjen e interesit dhe pamundësisë së tij për gjetjen e banesës.

Për çdo informacion shtesë, qytetarët mund të paraqiten pranë Sektorit të Kujdesit Social dhe PAK në Bashkinë Devoll.

**LISTA E APLIKANTËVE – VITI 2025**

| Nr | Emër | Atësi | Mbiemër | Data e kërkesës | Specifikim |
|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Elona | Emin | Uzhuri | 19.06.2025 | Në proces me bankat |
| 2 | Mikel | Hekuran | Ahmetli | 16.06.2025 | Në proces me bankat |
| 3 | Erinda | Përparim | Agolli | 14.07.2025 | Në proces me bankat |
| 4 | Donatela | Namik | Hoxha | 14.07.2025 | Në proces me bankat |
| 5 | Rovena | Bariq | Backa | 16.07.2025 | Në proces me bankat |
| 6 | Ardian | Ylli | Çobani | 14.07.2025 | Në proces me bankat |
| 7 | Florenc | Muamet | Zyfi | 17.07.2025 | Refuzuar nga banka |
| 8 | Ledia | Rapo | Limka | 19.08.2025 | Në proces me bankat |
| 9 | Artan | Ibrahim | Voda | 06.10.2025 | Në proces me bankat |
| 10 | Sokol | Vasil | Morava | 10.10.2025 | Refuzuar nga komisioni i Strehimit |

**Ky njoftim ka për qëllim informimin publik të familjeve përfituese dhe ndjekjen e mëtejshme të procedurave të miratuara për programin "Kredi e Lehtësuar nga Shteti**

**Drejtor i Shërbimit Social**

**Zerina Sinani**